Përshpejtim i zhvillimit dhe bashkëpunimit qytetar

Përmirësimi i politikave lokale të qeverisjes, nëpërmjet pjesëmarrjes demokratike të qytetarëve

REKOMANDIME

INSTITUTI I STUDIMEVE SOCIALE DHE HUMANE

USAID FROM THE AMERICAN PEOPLE

Rekomandime për përshpejtimin e bashkëpunimit dhe zhvillimit qytetar

A duhet konsideruar reforma administrative dhe territoriale si një projekt final?

Artan Sadiku
Leart Kola
Joleza Koka
Greta Llambro

INSTITUTI I STUDIMEVE SOCIALE DHE HUMANE

USAID FROM THE AMERICAN PEOPLE



Artan Sadiku
Drejtori i Programit
Ka kryer doktoraturën në shkencat politike, menaxher në programe kërkimore dhe avokimi në Institutin e Shkencave Sociale dhe Shkencave Humane - Shkup, ka punuar si këshilltar i politikave të zhvillimit në Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim në Maqedoni dhe ka qenë këshilltar për Agjencinë Zvicerane të Zhvillimit në Maqedoninë e Veriut dhe Kosovë.



Leart Kola
Drejtor Ekzekutiv
Ka studiuar në Shkencat Politike dhe ka qenë një prej aktivistëve kryesorë të shoqërisë civile në Shqipëri për më shumë se dhjetë vjet. Ka punuar si menaxher i programit te Lëvizja MJAFT, studiues në ResPublica dhe këshilltar për politikat e punësimit në Qeverinë e Republikës së Shqipërisë. Është i përqendruar në përfshirjen sociale dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje.



Joleza Koka
Kërkuese shkencore
Ka kryer studimet për Zhvillimin Social Urban dhe Burimet Njerëzore si dhe për Arkitekturë dhe Dizajn Urban. Ajo është feministe dhe aktiviste politike, anëtare e Këshillit Bashkiak të Tiranës. Fushat e specializimeve të saj janë Arkitektura, Planifikimi Urban, Zhvillimi, Dizajni Interaktiv, Marketingu Dixhital, Planifikimi dhe Menaxhimi i Aktiviteteve, Menaxhimi i Ekipit.

Greta Llambro
Studiues i lartë
Ka mbaruar Fakultetin e Arkitekturës dhe Dizajnit Urbanistik, në Universitetin e Tiranës. Teza e saj i referohet rikualifikimit urban në qytete me perspektivë zhvillimi në Shqipëri. Ekspertizat dhe interesat e saj kërkimore lidhen më së shumti me arkitekturën si pjesë përbërëse e shoqërisë me një ndikim të drejtpërdrejtë në të, dhe një fokus të veçantë në zhvillimin urban.

Ky raport është përpiluar si pjesë e programit të USAID 'Përshpejtim i zhvillimit dhe bashkëpunimit qytetar-2017' nga Instituti i Studimeve Sociale dhe Humane

PARATHËNIE

Studimi i publikuar në dhjetor 2019 synon të nxisë debatin mbi: nevojat, kufizimet dhe kapacitet për ushtrimin e një proçesi përfshirës dhe pjesëmarrës të vendimmarrjes së qytetarëve dhe administratës në nivel lokal; modelet e duhura për praktikat e demokracisë lokale, duke angazhuar qytetarët dhe rritur ndërgjegjësimin e tyre.

Studimi me titull "Përshpejtim i zhvillimit dhe bashkëpunimit qytetar" realizuar nga Instituti i Studimeve Shoqërore me përkrahjen e USAID dhe me bashkëpunimin e shumë ekspertëve në nivel kombëtar dhe lokal, është ndër të vetmit publikime të këtij lloji i realizuar në Shqipëri, që analizon indikatorët zhvillimor dhe tërësor të reformës territoriale në bashkitë e Tiranës, Lezhës, Sarandës, Peshkopisë, dhe Korçës me qëllim që të mundësojë një pasqyrë më të qartë se si dallimet gjeografike, ekonomike dhe demografike ndikojnë në kushtet për demokracinë lokale dhe pjesëmarrjen qytetarëve.

Studimi i publikuar në dhjetor 2019 synon të nxisë debatin mbi: nevojat, kufizimet dhe kapacitet për ushtrimin e një proçesi përfshirës dhe pjesëmarrës të vendimmarrjes së qytetarëve dhe administratës në nivel lokal; modelet e duhura për praktikat e demokracisë lokale, duke angazhuar qytetarët dhe rritur ndërgjegjësimin e tyre; gjenerimin e proçeseve bashkëpunuese me faktorët politik në nivel lokal, si dhe transparencë në llogaridhënie nga ana e njësive të qeverisjes vendore; asistencën ndaj institucioneve shtetërore në zbatimin e objektivave për reformën territorial; ndikimin në debatet publike mbi reformën territoriale, decentralizimin dhe demokratizimin në përputhje me objektivat.

Praktika e demokracisë lokale në Shqipëri përpara reformës territoiale si pengesë kryesore ka pasur fragmentim të thellë. Në 373 njësitë e vetadministrimit lokal, që ekzistonin më parë, më së shumti vuanin nga mungesa e kapaciteteve dhe burimeve njerëzore si dhe nga niveli i ulët i decentralizimit të kompetencave për të ushtruar praktika demokratike në territorin nën administrim.

Qeverisja lokale do të ketë më shumë kompetenca sipas reformës territoriale me punët, që ka në ngarkim, të cilat janë të një rëndësie shumë më të madhe për qytetarët në njësitë e reja administrative. Por, pa një proces të reformuar të bashkëveprimit ndërmjet njësive të reja të qeverisjes lokale dhe qytetarëve, qeverisja lokale do të ndjekë veprimtarinë e trashëguar dhe do ti injorojë nevojat dhe të drejtën demokratike të qytetarëve për të marrë pjesë në vendimarrjen në nivel lokal.

Në krahasim me vendet e tjera në rajon, Shqipëria ka një praktikë më të dobët të demokracisë lokale. Kjo më së shumti është pasojë e zvarritjes së proçesit të decentralizimit dhe si pasojë shpërndarje më të ulët të fondeve dhe resurseve për këto praktika. Krahasimisht, Maqedonia e Veriut dhe Kosova kanë shumë më tepër përvojë dhe tregojnë rezultate më të mira në adresimin e nevojave të qytetarëve në nivel lokal.

Prandaj ky studim ka për qëllim të ofrojë një analizë të kushteve dhe dinamikave në nivel lokal si njohuri themelore rreth krijimit të mekanizmave dhe instrumenteve për pjesëmarrje demokratike në 61 Njësitë e reja të vetqeverisjes lokale.

GJETJET KRYESORE

Përzgjedhja e bashkive të Tiranës, Lezhës, Sarandës, Peshkopisë, dhe Korçës kishte për qëllim, që të mundësojë një pasqyrë më të qartë se si dallimet gjeografike, ekonomike dhe demografike ndikojnë në kushtet për demokracinë lokale dhe pjesëmarrjen qytetare.

Reforma territoriale si një ligj i përgjithshëm reformues kombëtar nuk duhet të shihet si një projekt definitiv, që rezulton në sjelljen e ligjeve sipas supozimeve të saj paraprake. Për shkak të karakterit kompleks të lendës, që kjo reformë adreson hulumtimi ynë tregon se disa aspekte të saj duhet të realizohen duke pilotuar dhe hulumtuar forma dhe modalitete të ndryshme të implementimit të saj.

Për këtë qëllim, ne propozojmë që reforma territoriale duhet të kalojë në fazë rishikimi duke pasur parasysh të dhënat analitike dhe empirike në sferën e shërbimeve dhe zhvillimit lokal. Pas testimit të suksesshëm të modeleve të riorganizimit territoral, tërësia legjislative, që shërben për realizimin e reformës duhet të hapet për rishikime dhe përmirësime.

Aspektet kryesore që kjo analizë ka gjetur si mundësi për përmirësimin e efekteve lokale nga implementimi i reformës territoriale kanë të bëjnë me:

• Përforcimin e praktikave lokale nga ana e strukturave civile për të dhënë shembull të suksesit, që do të motivojnë qytetarët të besojnë dhe të qasen në praktika të demokracisë lokale;

• Krijimin e formave dhe praktikave të reja institucionale në nivel lokal, forma të cilat risin transparencën e qeverisjes lokale si dhe mundësojnë pjesëmarrjen demokratike në vendimmarje në nivel lokal;

• Koordinimin më të mirë të institucioneve qendrore dhe atyre lokale për politikat, që nuk përputhen me logjikën e tanishme të organizimit lokal duke krijuar agjenci dhe fonde, që mundësojnë efektivitet më të madh zhvillimor lokal.

REKOMANDIME LIGJI I TIRANËS

Përmes studimit prozojmë, që të ketë një ligj të veçantë për administrimin e qytetit të Tiranës, ashtu siç ka pjesa dërrmuese e kryeqyteteve evropiane. Me këtë ligj të rregullohet qyteti i Tiranës; si një njësi e veçantë e vetëadministrimit lokal, kompetencat dhe financimi i qytetit si dhe bashkëpunimi i Bashkisë së Tiranës me bashkitë e tjera në Shqipëri dhe me qeverinë qendrore.

Ligji i Tiranës, do i mundësonte kryeqytetit, që të ndërtonte një planifikim financiar më të qëndrueshëm dhe më afatgjatë, duke qenë se ky ligj mund ti japë mundësinë të ngarkohet me borxh, brenda apo jashtë vendit, sipas kushteve që përcaktohen në ligj. Po ashtu në pajtim me ligjin, Bashkia Tiranë mund të japë garanci dhe të ndërmarrë obligime, të cilat mund të dalin nga huazime afatgjata të ndërmarrjeve publike që ata vetë i kanë themeluar. Mendojmë që kjo pavarësi financiare do mund të shoqërohej, me një përgjegjësi më të madhe të Bashkisë së Tiranës, tek ato fusha në të cilat sot mban përgjegjësi vetëm qeveria qëndrore. Këtu mund të përmendim politikat e punësimit (ky ligj do mund të shtrihej dhe në kredi apo grante që vetë administrata lokale mund të japë për të adresuar këtë problem), gjithashtu dhe me politikën fiskale të ndërmarrjeve private që operojnë në territorin e Tiranës. Po ashtu kjo pavarësi do ishte shumë e rendësishme për ti dhënë një dinamikë të re ekonomike kryeqytetit, por dhe do shkonte në harmoni me ndarjen e re territoriale që e 24-fishon hapësirën fizike të menaxhimit të qytetit.

Përcaktimi i një ligji të veçantë për menaxhimin e qytetit të Tiranës, plotëson dhe kushtin kryesor për çdo kryeqytet, që është cilësia e jetës së banorëve të tij. Për këtë arsye sygjerojmë, që vetëm për Tiranën të ketë një rishikim të ndarjes territoriale.
Sipas analizës sonë, vlerësojmë që rreziku më i madh i kryeqyteteve sot në botë është segregimi i banorëve dhe krijimi i zonave periferike, që ndikojnë në aspektin social dhe ekonomik. Ndarja e sotme i pamundëson qytetit të Tiranës menaxhimin e plotë në logjikë territoriale jo vetëm në aspektin social por dhe menaxhimin e strukturave kryesore siç është për shembull "aeroporti", që sot është në një varësi të disa bashkive dhe e bën të vështirë investimin si në të, por dhe në hapësirat përreth tij, në infrastrukturë e shërbime. Ndërkohë që do ishte më e logjikshme, që këtë peshë financiare ta mbante Bashkia e Tiranës si bashkia më e madhe në vend, gjithashtu edhe sepse aeroporti në mënyrë të natyrshme lidhet territorialisht me Bashkinë e Tiranës.

Një problem tjetër në ndarjen e re territoriale është dhe kufizimi mes Tiranë –Vorë - Kamëz. Ndarja mes Bashkisë së Vorës dhe Kamzës, krijon "geto" brenda vetë zonës urbane të qytetit, ku kufiri i Kamzës është brenda në zonën urbane të qytetit, ndërsa ai i Vorës gjendet mes kryeqytetit dhe rrugës për të aksesuar portin më të madh në vend, siç është ai që gjendet në Bashkinë e Durrësit.

Mendojmë që nëse në të ardhmen do ketë një rishikim të reformës territoriale të rishihet pozicioni i Bashkisë Vorë dhe Kamëz, kjo shkon dhe me trendin e natyrshëm të zhvendosjes së popullsisë në qytete të mëdha. Në këtë kuadër Tirana është e "dënuar" që të rritet në numër të banorëve sepse dhe mundësitë e punësimit janë më të mëdha aty. Në fakt ky do ishte dhe hap i parë, që në një të ardhme mbase jo të afërt, mund të bashkonte më shumë në aspektin e strategjisë së zhvillimit urban për Tiranën me Durrësin, ku nga eskperienca dhe duke parë trendin e zhvillimit mund të humbi plotësisht kufiri ndarës mes tyre duke e bërë atë një qytet të vetëm, sic ka ndodhur me hapësira të tjera metropolitane në botë.

REKOMANDIME

NDARJA TERRITORIALE / SHERBIMET

Ligji i veçantë për Tiranën, do mund të ndihmonte në parashikimin e trendit të zhvillimit dhe bërjen të mundur të shmangies së kaosit urban, që ka shenjuar zhvillimin e Tiranës dhe Durrësit, por mbi të gjitha do ishte e rendësishme për ti dhënë mundësi investimeve publike apo private të ndjekin një logjikë të zhvillimit të planifikuar, si parakusht për të garantuar "cilësinë e jetës së banorëve", që është dhe qëllimi kryesor pse ne kemi qytete apo aq më shumë pse kemi kryeqytete.

Përveç qytetit të Tiranës, nga konsultimet e bëra në terren, ne nuk mendojmë, që duhet të ketë ndarje drastike territoriale në afat shkurtër për bashkitë e tjera, por mendojmë se duhet patjetër një rishikim i ofrimit të shërbimit në zonat rurale.

Aktualisht kemi mundësi të bëjmë një parashikim siç e thamë dhe më lart, për ndryshimet demografike që do ndodhin, për të mos u gjendur të papërgatitur si në rastet e ndryshimeve të mëdha në fillim viteve 90'. Nisja e një projekti të parashikimit të lëvizjes së banorëve në zonat urbane, apo në zonat rurale më të favorizuara, duke përfshirë dhe ato që mund të jenë atraktive për zhvillimin e turizmit, mund të planifikojmë dhe vendosjen e shërbimeve shtetërore në të ardhmen.

Në kuadër të rishikimit të shërbimeve mund të preket dhe ajo e menaxhimit të bujqësisë, e cila mendojmë që duhet të këtë një logjike të sajën të ndarjës territoriale. Shembull është fusha e Korcës, e cila është një zonë e rendësishme bujqësore dhe që sot ndahet nga tre bashki siç është ajo e Korcës, Maliqit dhe Pogradecit. Ne mendojmë, që strukturat e bujqësisë do duhet të mbetet në qeverinë qëndrore sidomos menaxhimi i saj në drejtori që i shkojnë logjikës së investimeve në bujqësi.

Menaxhimi i bujqësisë dhe decentralizimi i saj ka qënë një çështje që ka dalë në të gjithë takimet që kemi bërë, mëndojmë që për këtë do duhet të ketë një studim të veçantë dhe që fokusohet posaçërisht tek shërbimet bujqësore, tregjet mundësia e zhvillimit të rajonit etj. Pavarisht të dhënave, që kemi pasqyruar në studim, si pasojë e shqetësimit të madh që ekziston, mendojmë që ky studim për pjesën e bujqësisë nuk duhet konsideruar shterues mbi këtë çështje por vetëm si pikënisje.

REKOMANDIME

STRUKTURA QYTETARE DHE ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE

Strukturat qytetare (ndërmjetësit e komunitetit, kryepleqtë) dhe organizatat e shoqërisë civile, që kanë në fokusin e tyre monitorimin e administratës lokale, janë shumë të rendësishme jo vetëm për forcimin e komuniteteve por mbi të gjitha për monitorimin e administratës lokale e cila me ndarjen e re territoriale ka një vendimmarrje përherë e më të centralizuar. Ne inkurajojmë agjencitë, që menaxhojnë fonde publike, por dhe donatorët e huaj që të fokusohen në mbështetjen e këtyre organizmave, forcimi i tyre është garanci për mobilitetin në komunitet dhe monitorimin jo vetëm të administratës së bashkisë por dhe mbarëvajtjes së strukturave arsimore apo shëndetësore, që janë në varësi të ministrive si dhe ndërmarrjeve të shoqërive aksionere (psh. ujësjellësat) që operojnë në nivel lokal.

Këto struktura mund të kryejnë një punë të rëndësishme në komunitet gjithashtu për organizim dhe sensibilizim në fushatat që kanë të bëjnë me menaxhimin e burimeve natyrore, siç është ruajtja e mjedisit apo e ujit, parqet rekreative, aktivitetet kulturore, apo dhe fushata që kanë mbetur në letër akoma, si "shkollat si qendra komunitare". Mund të jenë një fillim i mbarë, që të decentralizohen nga administrata dhe të marrin më shumë përgjegjësi organizatat e shoqërisë civile apo dhe organizatat komunitare (ndërmjetës komuniteti, kryepleqtë).

Mungesa e presionit të organizuar qytetar, mund të rezultojë në problem në rrafshin e demokracisë përfaqësusese në kushtet e reformës së re territoriale për tendencën e centralizimit të vendimmarrjes në pak përfaqësues të votuar. Pas studimit të kryer në terren, besojmë që administrata lokale i ka kapacitetet për të ofruar një shërbim më të mirë dhe me transparent si pasojë e kësaj ndarje të re territoriale, meqënëse në shumicën e rasteve rritja e territorit ka ardhur dhe me rritjen e buxhetit për investime dhe për burime njerëzore por vihet re gjithashtu një injorim i mendimit të qytetarëve kur vjen puna tek investimet publike apo qasjen urbanistike të qyteteve. Formalizimi i mendimit dhe vendimeve të strukturave të shoqërisë civile brenda administratës lokale, në borde të ndërmarrjeve dhe njohja e pjesëmarrjes së tyre me ligj, do mund të prodhojë një formë të re të bashkëpunimit të administratës lokale, me të zgjedhurit lokal (kryepleqtë dhe ndërlidhësit e komunitetit) apo të vetëofruarit (si në rastin e organizatave të shoqërisë civile).

Në finale, propozojmë një rishikim të ligjit të administratës lokale dhe strukturave përfaqësuese, që të kenë një bord qytetar vullnetar të papaguar që të jetë strukturë informuese për planet e investimeve të bashkive, të cilët do mund të konsultohen përpara së çështjet të kalohen në Këshillin Bashkiak, dhe gjithashtu të përfshihen në bordet e ndërmarrjeve të bashkive apo dhe ato që janë shoqëri aksionere, njerëz nga organizatat e shoqërisë civile të cilët do mund të monitoronin më nga afër që vendimmarrjet e këtyre ndërmarrjeve të shkojnë me planin dhe interesat e qytetarëve.

REKOMANDIME

MONITORIMI I ADMINISTRATËS LOKALE

Strukturat qytetare dhe organizatat e shoqërise civile, që kanë në fokusin e tyre monitorimin e administratës lokale, janë shumë të rëndësishme jo vetëm për forcimin e komuniteteve por mbi të gjitha për monitorimin e administratës lokale, e cila me ndarjen e re territoriale ka një vendimmarrje përherë e më të centralizuara. Ne inkurajojmë si agjencitë, që menaxhojnë fonde publike, por dhe donatorët e huaj, që të fokusohen në mbështetjen e këtyre organizmave sepse forcimi i tyre është garant për mobilitetin komunitar dhe monitorimin jo vetëm të administratës së bashkisë, por dhe mbarëvajtjes së arsimit, shëndetësisë si dhe ndërrmarjeve të shoqërive aksionere siç janë ujësjellsat. Ata mund të kryejnë një punë kapilare në komunitet për organzim dhe sensibilizim, si në mbarëvajtjen e burimeve natyrore (kursimi i ujit) apo dhe promovimin e vlerave komunitare.Ne mendojmë pas studimit të kryer në terren, që bashkitë i kanë burimet njerëzore dhe kapacitetet për të adresuar kërkesat e qytetarëve por mungesa e presionit të organizuar dhe mos ekzistenca e strukturave komunitare krijon vakum mes kërkesës qytetare dhe administratës publike. Rritja e kërkesës qytetare për pjesëmarrje në vendimmarrje në nivel lokal mund të sjellë në një afat të shkurtër përmirësimin e dukshëm të shërmbimeve nga administratorët lokalë.

STRUKTURAT E NDËRMJETËSIMIT TË QYTETARËVE SI MOTORR I DEMOKRACISË

Ka disa struktura, që tashmë njihen me ligj nga shteti Shqiptar, nder të cilat janë kryepleqtë në zonat rurale dhe ndërmjetësit e komunitetit në zonat urbane. Propozojmë që këto struktura të paguhen më mirë dhe të kenë më shumë përgjegjësi ndaj propozimeve, që u vijnë nga qytetarët. Ne besojmë, që forcimi i tyre mund të shkojë në drejtim dhe të koordinimit të problemeve të qytetarëve me institucione të tjera siç janë policia, shërbimet sociale, Ministria e Bujqësisë etj, duke ju shtuar edhe përshkrimin e punës. Rekomandojmë, që ndërlidhësit e komunitetit dhe kryepleqtë të funksionojnë jo vetëm si "whistle-blower" por të kenë buxhet dhe kompetenca për të bërë organizime komunitare duke ndihmuar në organizimin e strukturave përfaqësuese komunitare. Ndërlidhësit dhe kryepleqtë të ndihmojnë në lehtësimin e krijimit të bordeve në çdo lagje. Këto borde, të cilat rekomandojmë, që të krijohen sidomos në qytetet e mëdha si Tirana, Durrësi, Elbasani etj. të jenë të zgjedhura nga banorë ku përfaqësuesit të mbulojnë territore me jo më shumë se 20 mijë banorë dhe të jenë reflektim i hapësirave urbane të ndërlidhur me njëra-tjetrën përmes blloqeve të pallateve. Besojmë që nëse këto borde janë të zgjedhura nga një proces, që do të realizohet me angazhimin e strukturave lokale, do shërbejë jo vetëm për krijimin e një fryme komunitare, e cila po humbet përherë e më shumë nga ndryshimet demografike sidomos në qytetet e medha, por dhe do mund të shërbente si grup presioni për të avancuar axhenden e kërkesave të tyre jo vetëm në institucionet lokale por dhe ato qendrore.

REKOMANDIME

REFERENDUMET LOKALE

Referendumet në Shqipëri janë një mit, referendumet lokale janë akoma më të pamundura, e në gjithë historinë e saj Shqipëria nuk ka pasur asnjë referendum lokal, kjo dhe për faktin që korrniza ligjore e këtyre referendumeve ka qënë pothuajse e pamundur për tu plotësuar dhe e paqartë për tu debatuar. Sa i përket këtyre referendumeve gjithmonë ato kanë mbajtur diskrecionin e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve apo Qeverisë për t'u lejuar, rasti i TEC-it të Vlorës, të cilin mund ta trajtosh dhe si një investim lokal ku duhen pyetur qytetarët e Vlorës, por dhe si një investim strategjik kombëtar ku në këtë pikë ai shtrihet në nivel kombëtar. Një tjetër tentativë e shoqërisë civile është ajo e ndalimit të importit të plehrave. Procedurat për të kërkuar një referendum lokal janë të njëjtat me një referendum kombëtar, që rrjedhimisht e bën tepër të veshtirë për të mos thënë të pamundur aplikimin e kësaj të drejte demokratike.

Propozojmë, që si fillim të ketë proçedura të veçanta dhe referendumet lokale të lehtësohen për t'u kërkuar nga një grup banorësh, reforma territoriale, shumëfishimi në territor i bashkive e kërkon këtë gjë si domosdoshmëri e ruajtjes së nivelit të pjesëmarrjes demokratike dhe promovimin e qytetarisë aktive. Më parë të përzgjedhurit përfaqësonin një grup më të vogël banorësh, sepse në këtë proces ishte dhe kryetari i komunës dhe Kryetari i Minibashkisë, sot kemi një situatë tjetër ku në Tiranë për shembull ku jeton gati 1/3 e popullsisë së vendit, banorët janë të thirrur të votojnë vetëm për kryetarin e bashkisë apo keshillin bashkiak nëpërmjet listave të mbyllura të prezantuara nga partitë politike, e ndërkohë për asnjë strukturë tjetër të ndërmjetme. Ne propozojmë, që kjo të ndryshojë duke lehtësuar procedurat e referendumeve lokale.
Gjithashtu mendojmë, që duhen eksploruar forma të votimit elektronik. Kemi parë tentativa të implementuara nga Kryetari i Bashkisë Tiranë, Erion Veliaj, për t'u konsultuar me banorët për të ndryshuar një ditë festimesh apo për të thirrur qytetarët që të votojnë për logon e qytetit, duke përdorur rrjetet zyrtare sociale të bashkisë. Mund të jetë një hap i parë në ndërtimin e një sistemi, më institucional, më të kontrolluar nga i cili opinion i qytetarëve për tema të caktuara mund të merret dhe mund të konsiderohet zyrtar pa shpenzuar të ardhura nga taksat në organizmin e një opinionmarrjeje me mjetet tradicionale të njohura zyrtarisht sot në vendin tonë.

Ne propozojmë, që iniciativat elektronike publike për matjen e mendimit qytetar të rregullohen me Vendim të Këshillit Bashkiak e të propozohen si alternativë në angazhimin qytetar dhe marrjen e mendimeve për projekte të ndryshme publike, që ndodhin në komunitetin e tyre.

PERMBLEDHJE

Ligji i Tiranës

Përmes studimit prozojmë, që të ketë një ligj të veçantë për administrimin e qytetit të Tiranës, ashtu siç ka pjesa dërrmuese e kryeqyteteve evropiane. Me këtë ligj të rregullohet qyteti i Tiranës; si një njësi e veçantë e vetëadministrimit lokal, kompetencat dhe financimi i qytetit si dhe bashkëpunimi i Bashkisë së Tiranës me bashkitë e tjera në Shqipëri dhe me qeverinë qendrore. Përcaktimi i një ligji të veçantë për menaxhimin e qytetit të Tiranës, plotëson dhe kushtin kryesor për çdo kryeqytet, që është cilësia e jetës së banorëve të tij.

Ndarja Territoriale/Shërbimet

Përveç qytetit të Tiranës, nga konsultimet e bëra në terren, mendojmë se duhet patjetër një rishikim i ofrimit të shërbimit në zonat rurale. Shembull është fusha e Maliqit, e cila është një zonë e rendësishme bujqësore dhe që sot ndahet nga tre bashki siç është ajo e Korcës, Maliqit dhe Pogradecit. Një shembull tjetër është "aeroporti", që sot është në një varësi të disa bashkive dhe e bën të vështirë investimin si në të, por dhe në hapësirat përreth tij, në infrastrukturë e shërbime.

Struktura qytetare dhe organizatat e shoqërisë civile

Ne inkurajojmë agjencitë, që menaxhojnë fonde publike, por dhe donatorët e huaj që të fokusohen në mbështetjen e këtyre organizmave sic jane Strukturat qytetare (ndërmjetësit e komunitetit, kryepleqtë). Gjithashtu propozojmë një rishikim të ligjit të administratës lokale dhe strukturave përfaqësuese, që të kenë një bord qytetar vullnetar të papaguar, që të jetë strukturë informuese për planet e investimeve të bashkive të cilët do mund të konsultohen përpara se çështet të kalohen në Këshillin Bashkiak.

Monitorimi i administratës lokale

Ne mendojmë pas studimit të kryer në terren, që bashkitë i kanë burimet njerëzore dhe kapacitetet për të adresuar kërkesat e qytetarëve por mungesa e presionit të organizuar dhe mos ekzistenca e strukturave komunitare krijon vakum mes kërkesës qytetare dhe administratës publike. Rritja e kërkesës qytetare për pjesëmarrje në vendimmarrje në nivel lokal mund të sjellë në një afat të shkurtër përmirësimin e dukshëm të shërmbimeve nga administratorët lokalë.

Strukturat e ndërmjetësimit të qytetarëve si motorr i demokracisë

Propozojmë, që strukturat e kryepleqve në zonat rurale dhe ndërmjetësit e komunitetit në zonat urbane, të paguhen më mirë dhe të kenë më shumë përgjegjësi ndaj propozimeve, që u vijnë nga qytetarët. E njëjta gjë vlen të thuhet edhe për anëtarët e këshillave bashkiak, të cilët megjithëse të zgjedhur me votë marin vetëm honorar për pjesëmarrjen në mbledhjet mujore, ndryshe nga të gjitha bashkitë e tjera në rajon apo Europë ku paguhen për punën e tyre.

Referendumet lokale

Propozojmë, që si fillim të ketë proçedura të veçanta dhe referendumet lokale të lehtësohen për t'u kërkuar nga një grup banorësh. Gjithashtu mendojmë, që duhen eksploruar forma të votimit elektronik. Ne propozojmë, që iniciativat elektronike publike për matjen e mendimit qytetar të rregullohen me Vendim të Këshillit Bashkiak e të propozohen si alternativë në angazhimin qytetar dhe marrjen e mendimeve për projekte të ndryshme publike, që ndodhin në komunitetin e tyre.